



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.347/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Zyhdi Haziri dhe Faton Ademi anëtar, si dhe me pjesmarrjen e Zyrtares Ligjore Anita Peci, duke vendosur përkitazi me ankesën e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe Internews Kosova (IKS), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR) me seli në Prishtinë, dega në Ferizaj, për shkak të Thyerjes së Heshtjes Zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 24.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

PRANOHET si e bazuar ankesa e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe Internews Kosova (IKS), me seli në Prishtinë, e cila mban shenjën ZL.Anr.347/2017, e datës 22.10.2017, kështu që subjektit politik, Aleanca Kosova e Re (AKR) dega në Ferizaj, i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 250.00 (dyqind e pesëdhjet) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të këtij vendimi **nën kërcënim të përmbarimit**.

A r s y e t i m

PZAP-i më datë 22.10.2017, ka pranuar një ankesë nga Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe Internews Kosova (IKS), në të cilën ka theksuar se kandidati i AKR-së për Kryetar të Ferizajit, Amir Rexhepi, në profilin e saj në facebook, më datë 22.10.2017, në orën 12:09 minuta, ka publikuar fotografën e tij me logon dhe numrin e partisë si dhe me mbishkrimin “Ju ftojme që të votoni për kandidatin për kryetar të Komunës së Ferizajit , Amir Rexhepi”. Më tej ka theksuar se ky veprim është në kundërshtim me nenin 36 paragrafi 1 pika b) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP-së).

Parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur fotografi.

Në përgjigjen në ankesë të datës 23.10.2017, subjekti politik Aleanca Kosova e Re (AKR), ka theksuar se publikimi i bërë në rrjetin social facebook të kandidatit të AKR-së, gjatë heshtjes zgjedhore, është bërë pa dijen e tij, pasi që personat përgjegjës për faqen e tij, nuk kanë qenë në dijeni se me këtë veprim mund të thyejnë heshtjen zgjedhore.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Paneli, nga fotografia e ofruar si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës, ka vlerësuar se kandidati për Kryetar të Komunës së Ferizajit nga radhët e subjektit politik AKR, Amir Rexhepi, ka shkelur rregullat zgjedhore, duke bërë thyerje të heshtjes zgjedhore, pasi që me datë 22.10.2017 rreth ores 12:09, në profilin e tij në facebook, ka publikuar fotografimin e tij me logon dhe numrin e partisë si dhe me mbishkrimin “Ju ftojme që të votoni për kandidatin për kryetar të Komunës së Ferizajit , Amir Rexhepi” veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 36 paragrafi 1 pika b) të LZP-së e cila përcakton se: *“Njëzetekatër (24) orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës, e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohet bërja e fushatës në çfarëdo mënyre”*.

Andaj, Paneli në kuptim të nenit 118 dhe nenit 120 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.347/2017 me datën 24.10.2017

Kryesuesi i Panelit
Rafet Haxhaj



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së